



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Adresa: Rruga: "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site:www.klsh.org.al

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ 2019

**V E N D I M**

Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUTIN E SIGURIMEVE SHOQËRORE TIRANË**  
**“MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË”**  
**për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datën 31.12.2018.**

Nga auditimi i ushtruar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore Tiranë rezultoi ndër të tjera se për , pasqyrat financiare të konsoliduara të ISSH të vitit 2018, pavarësisht se është arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mos përputhshmërisë, individualisht ose së bashku, nuk janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore të periudhës nën auditim, por ndërkohë theksojmë rezervën në lidhje me disa aspekte të cilat janë trajtuar në materjalin e auditimit të pasqyrave përmbledhëse të ISSH.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**VENDOSA:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe përputhshmërisë, të ushtruar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, sipas programit të auditimit nr. 1445/1 prot, datë 08.01.2019 për veprimtarinë nga data 01.01.2018 deri më datën 31.12.2018.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

**A. KONKLUZIONE DHE OPINIONI AUDITIMIT**

### **Opinion mbi pasqyrat financiare**

#### ***Opinion i pakualifikuar me rezervë, për pasqyrat e mbyllura në 31 Dhjetor 2018.***

Në gjykimin e KLSH-së, mbështetur në standardet ISSAI 1700 dhe ISSAI 1200, pasqyrat financiare vjetore të ISSH-së për vitin ushtrimor 1 Janar 2018 deri më 31 Dhjetor 2018, paraqesin një pamje të drejtë.

Nga ana e grupit të auditimit është kryer auditimin në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë, për pasqyrat financiare të konsoliduara ISSH viti 2018, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mos përputhshmërisë, individualisht ose së bashku, nuk janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore të periudhës nën auditim, por ndërkohë që theksojmë rezervën në lidhje me disa aspekte të cilat janë përmendur gjatë auditimit të pasqyrave përmbledhëse të ISSH.

### **Opinion mbi përputhshmërinë me bazën ligjore dhe rregullative në fuqi**

Nga auditimi i veprimtarisë së ISSH me rregullat financiare dhe rregulloret për implementimin e rregullave financiare të ISSH, në opinionin tonë rezulton se, veprimet e raportimit financiar janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor kontabël, të aplikueshëm dhe përkatës si me parimet dhe rregullat. Gjithashtu transaksionet e kryera gjatë ekzekutimit të buxhetit të ISSH kanë qenë në të gjitha aspektet në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullative në fuqi. Pasqyrat financiare (bilancet dhe pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve) në përgjithësi kanë reflektuar parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** ISSH nuk ka zbatuar 6 rekomandime të lëna nga KLSH, 3 (tre) rekomandime janë në proces dhe 5 (pesë) rekomandime janë zbatuar pjesërisht. *(Më hollësisht trajtuar në pikën "A" nga faqe 12 deri në 32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Përsa më sipër rekomandoj:** Strukturat drejtuese të ISSH, të marrin masa të përcaktojnë personat përgjegjës dhe analizojnë nivelin e zbatimit të rekomandimeve, me qëllim zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces dhe atyre ende të pa zbatuara, me qëllim përmirësimin e punës, brenda vitit 2019.

### **Brenda vitit 2019**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore u konstatua se ISSH ka funksionuar mbi bazën e një rregulloreje për organizimin e detyrave funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme në ISSH-së e cila nuk është miratuar në KA.

- Struktura organizative sipas kësaj rregullore, paraqitet me mangësi në përcaktimin e kriterëve të arsimit dhe eksperiencës në punë, për disa pozicione pune të drejtorisë të Aparatit të ISSH-së si dhe për të gjitha pozicionet e punës për Drejtoritë Rajonale.

- Për disa pozicione pune nuk përputhet emërimi i punonjësve sipas strukturës organizative me kriterin e arsimit të përcaktuar.

- Ndryshimet në strukturën organizative dhe numër punonjësish të Drejtorisë së Përgjithshme janë kryer me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm dhe nuk janë miratuar në KA.

- Nuk janë ndjekur procedurat ligjore të rekrutimit dhe komandimit për vendet e punës vakante. Edhe pas largimit të punonjësve, këto pozicione pune nuk janë paraqitur si vende vakante nga sektori i personelit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën "B" nga faqe 33 deri në 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

### **Përsa më sipër rekomandoj :**

**a.** ISSH në Rregulloren për organizimin e detyrave funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH-së, të rishikojë dhe plotësojë pozicionet e punës për Drejtorinë Qendrore dhe të drejtorive rajonale me kriteret e arsimit dhe të eksperiencës në punë si edhe për emërimin e punonjësve të zbatohen kriteret sipas strukturës së miratuar. KA të miratojë rregulloren për organizimin e detyrave funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH-së, ku të pasqyrohen ndryshimet në strukturën organizative sipas nevojave të drejtorive përkatëse të institucionit, me qëllim që të bëhet më efektiv zbatimi i detyrave dhe referenca të jetë konform përcaktimeve në Statutin e ISSH dhe ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.

**b.** ISSH të zbatojë dhe të dokumentojë rregullat dhe procedurat e rekrutimit dhe komandimit, të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës të punonjësve si dhe të plotësojë vendet e lira të punës në përputhje me strukturën organizative dhe aktivitetin aktual të ISSH-së të përcaktuara në VKA nr. 3/2, datë 26.02.2008 *"Për miratimin e Rregullores për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore"* për të garantuar transparencë dhe që procesi i menaxhimit dhe vlerësimit të burimeve njerëzore të mbështesë dhe nxisë përmbushjen e objektivave të ISSH-së.

### **Në vazhdim**

### **3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Administrativ (KA) si:

- Për funksionimin e KA nuk është zbatuar neni 72, i ligjit nr. 7703, pika 1/a *"Përbërja dhe Emërimi i Këshillit Administrativ"*, sepse nga 12 anëtarë që duhet të emëroheshin, janë emëruar 11. Me ndryshimin e varësisë së ISSH-së nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Ministrinë e Financave, Këshilli Administrativ me VKA nr. 1, date 18.04.2018 ka vendosur ti propozohet KM ndryshimi në ligjin për sigurimet shoqërore për përbërjen e anëtarëve të KA. Sipas këtij vendimi është propozuar se pjesë e anëtarëve të Këshillit Administrativ duhet të jenë dy përfaqësues të Ministrisë së Financave, një në rolin e Kryetarit të KA, konkretisht Ministri i Financave dhe tjetri zv/ministri i financave. Ky propozim është bërë për të mos pasur ndryshime në përbërjen e Këshillit Administrativ sa herë që ndryshon qeveria, por rrishton përfaqësimin e institucioneve të tjera.

-Nuk ka punonjës të emëruar në funksionin e Sekretarit të Këshillit Administrativ, në kundërshtim me nenin 19, të VKM Nr. 161 *"Për miratimin e Statutit të ISSH-së"* ku specifikohet se: *"Kryetari i KA-së duhet të autorizojë një person të përhershëm për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes"*, si dhe nenit 2 pika 1, të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 *"Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"*.

-KA ka zhvilluar dy mbledhje, në kundërshtim me Statutin e ISSH-së, Kreu V , neni 15 i tij, ku citohet se; *"Këshilli Administrativ mblidhet jo më pak se 4 herë në vit"*.

-Rezultati financiar i vitit 2017 nuk është miratuar sipas rregullores financiare, pika *"Kontrolli financiar dhe raportimi"*/çështja D *"Raportimi"*/nën çështja 3, ku specifikohet se *"raporti vjetor së bashku me bilancin si shtojcë pas aprovimit nga KA, duhet botuar jo më vonë se fundi i tremujorit të dytë, që pason vitin të cilit ai i referohet"*. *(Më hollësisht trajtuar në pikën "B" nga faqe 33 deri në 44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Përsa më sipër rekomandoj:**

Të vlerësohet dhe gjykohet mundësia që një anëtar i KA të jetë përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duke qenë se Instituti i Sigurimeve Shoqërore operon me skemat e fermerëve, për të shmangur praninë e dy përfaqësuesve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

- Të merren masa që në mbledhjet e ardhshme të KA-së, të emërohet një punonjës në funksionin e Sekretarit të Këshillit Administrativ, në përputhje me VKM nr.161 datë 11.04.1994 “Për miratimin e Statutit të ISSH-së”

-Strukturat drejtuese të ISSH-së të reflektojnë në zbatimin të Statutit të ISSH-së mbi zhvillimin e mbledhjeve të KA-së, *jo më pak se 4 herë në vit*”.

- Këshilli Administrativ, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, duhet të miratojë pasqyrat financiare dhe rezultatin financiar të ISSH-së brenda afateve ligjore të përcaktuara në Rregulloren Financiare të institucionit.

**Në vazhdim**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, u konstatua se, nuk është vepruar plotësisht në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 07.08.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe me ato të Manualit Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për sa vijon:

-në raportin e kontrollit të brendshëm të ISSH dhe pyetësorit të vetëvlerësimit për vitin 2018, u identifikuan mangësi dhe pasaktësi në përgatitjen e Pyetësorit të Vetëvlerësimit;

-nuk ishte kryer një delegim i dokumentuar mbi përgjegjësinë lidhur me përzgjedhjen e koordinatorit të riskut dhe të MFK në ISSH;

-ISSH nuk disponon rregullore të brendshme për delegimin e detyrave, konfliktin e interesit, gabimeve, etj;

-nuk duhet të jetë pjesë e vendimmarrjes Drejtori i Auditit të Brendshëm, në mbledhjet e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS);

- nuk ka shkresë delegimi nga nëpunësi autorizues për koordinatorin e riskut

-paraqiten mangësi lidhur me dokumentimin e raportimit dhe shpërndarjes së informacionit nëpërmjet strukturave.

- nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën “B2” nga faqe 44 deri në 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Përsa më sipër rekomandoj:** Strukturat drejtuese të ISSH të marrin masat e nevojshme për forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke reflektuar kërkesat që burojnë nga ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollit.

**Brenda vitit 2019**

**5. Gjetje nga auditimi:** Përpunimi i të dhënave mbi transaksionet, mbajtja e kontabilitetit dhe përpilimi i pasqyrave financiare realizohet me program Office Excel dhe jo me ndonjë software më të përshtatshëm. Kjo ul sigurinë e përpunimit të informacionit kontabël dhe rrit mundësinë për gabime dhe manipulime, vonesa në dhënie informacioni ndonëse nuk u konstatuan raste të tilla në

përpilimin e pasqyrave financiare të vitit 2018. *(Më hollësisht trajtuar në pikën “C” nga faqe 50 deri në 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Përsa më sipër rekomandoj:** Drejtoria e Financës të marrë masa për aplikimin e një programi të përpunimit elektronik të kontabilitetit si dhe të Pasqyrave Financiare, ku të bëhet hedhja e të dhënave.

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga Drejtoria e Financës nuk mbahet një akt rakordim me Bankën e Shqipërisë për lëvizjet e likuiditeteve që ISSH kryen në dy nën llogari (“2001L dhe 3001L”), të çelura në Bankën e Shqipërisë, pasi MFE pretendon se këto dy llogari administrohen nga MFE. Mbajtja e akt rakordimit me BSH do të ndihmojë monitorimin e procesit të lëvizjeve të likuiditeteve nga MFE tek BSH (dy llogaritë e ISSH të hapura pranë saj). *(Më hollësisht trajtuar në pikën “C” nga faqe 52 deri në 55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Përsa më sipër rekomandoj:** Në institucion në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë në fund të vitit ushtrimor për lëvizjet e likuiditeteve që ISSH kryen në dy nën llogari (“2001L dhe 3001L”), të çelura në Bankën e Shqipërisë, të mbahen akt rakordimet përkatëse.

**Menjëherë**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga ISSH, për aktivet afat gjata (*ndërtesa, toka, makineri dhe pajisje*) në pronësi nuk është realizuar një rivlerësim që nga momenti i regjistrimit të tyre në kontabilitet, pra ato janë të paraqitura me koston historike. Kosto historike e një aktivi ose detyrimi ka disavantazhin që jo gjithnjë paraqet vlerën e saktë të tyre krahasuar me çmimet e tregut. *(Më hollësisht trajtuar në pikën “C” nga faqe 56 deri në 58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Përsa më sipër rekomandoj:** Nga ISSH të merren masa që gjatë planifikimit të shpenzimeve për periudhat e ardhshme të planifikojë një zë për shpenzimet që do të nevojiten për të bërë rivlerësimin e aktiveve (tokë, ndërtesë, makineri e pajisje). Rivlerësimet të kryhet në mënyrë të rregullt dhe të mjaftueshme, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivitetit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohet nëse do të përdorej vlera e drejtë në datën e bilancit. Vlera e drejtë e tokës dhe ndërtesave duhet të përcaktohet nga evidenca e bazuar në treg nëpërmjet një vlerësimi që ndërmerret nga vlerësues profesionistë të kualifikuar dhe në përfundim të këtij procesi të kryejë pasqyrimin e këtij rivlerësimi në kontabilitet.

**Brenda vitit 2019**

**8. Gjetje nga auditimi:** Shuma prej 22,623,879.28 lekë, e reflektuar në llogarinë 468 “Debitore të ndryshëm” e cila përfaqëson vlerën e librezave të kontributeve që Aparati ka shpërndarë në Rajonet e Sigurimeve Shoqërore e që këta të fundit ua shesin klientëve. Në kuptimin e të drejtave që ISSH ka për këtë aset, vlerësojmë se në pasqyrat e konsoliduara ky zë nuk ka kuptim të reflektohet me kundërpartit shumën respektive në llogarinë 411 “Klientë e llogari të ngjashme me to”, sikundër kemi konstatuar. Në pasqyrat financiare të konsoliduara Llogaritë e Pagueshme dhe ato të Arkëtueshme mes njërive shpenzuese dhe Aparatit duhet të eliminohen pasi cenohet parimi i vlerësimit që elementët futen në llogari dhe përfshihen në pasqyrat financiare me shumat përcaktohen sipas standardeve kontabël sipas standardeve të kontabilitetit, bazuar në Standardin e Kontabilitetit nr. 9, dhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat

financiare”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën “C” nga faqe 59 deri në 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Përsa më sipër rekomandoj:** Drejtoria e Financës të marrë masa që përgjatë konsolidimit të pasqyrave financiare të eliminojë llogaritë që mbartin të drejta dhe detyrime brenda grupit.

**Brenda vitit 2019**

**9. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të pasqyrave financiare të Aparatit të ISSH-së zëri “koncesione, patenta, licenca” paraqitet në total dhe e pa shoqëruar me inventar analitik gjë që e bën të pamundur saktësimin dhe identifikimin sipas llojit të kësaj llogarie dhe norma e amortizimit është llogaritur 5% mbi vlerën e mbetur dhe nuk i është referuar UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36 ku përcaktohet se: *-Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%*. Duke pasur parasysh se në bilancin e vitit 2018 llogaria 203 “koncesione , patenta, licenca” është e pandryshuar nga viti 2017 si dhe se totali i shpenzimeve të rrjetit të IT të vitit 2018 për llog. 6022500 “Mirëmbajtje të zakonshme të kompjuterë, vegla, aparate, etj”, paraqitet në shumën 82,800 mijë lekë, duhen përcaktuar saktë shpenzimet nëse janë mirëmbajtje apo përmirësime të këtij aktivi. Shpenzimet e vitit për mirëmbajtje IT, tejkalojnë 15% të vlerës së mbetur të aktivitetit dhe si të tilla duhet të rrisin vlerën e aktivitetit, pra të konsiderohen kosto përmirësimi dhe jo mirëmbajtjeje sipas kërkesës së udhëzimit nr. 1, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, pika 3.7.2 ku specifikohet se, *konsiderohen si kosto të përmirësimit, të rinovimit dhe të rikonstruksionit, shpenzimet që kanë për qëllim përmirësimin e kapacitetit përfitues të ardhshëm të aktiveve dhe vlefteve e të cilave është më e madhe së 15% e vlerës kontabile të mbetur të aktiveve. Kur këto shpenzime janë më të vogla së 15% e vlefteve kontabile të mbetur të aktivitetit përkatës, ato konsiderohen shpenzime për mirëmbajtjen e aktivitetit dhe pasqyrohen totalisht si shpenzime biznesi për periudhën korente*. Gjithashtu duhet plotësuar regjistri i aktiveve afatgjata jo materiale sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën “C” nga faqe 65 deri në 69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Përsa më sipër rekomandoj:** Drejtoria e Financës së ISSH-së të plotësojë regjistrin e Aktiveve Afatgjata jo materiale në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 8 datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, pika 36, “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Të bëhet sistemimi në zërat respektive të Bilancit kontabël (llogaria 203) në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Pasqyrën gjendja dhe ndryshimet e AAGJ si dhe në Pasqyrën e Të Ardhurave dhe Shpenzimeve (llogaria 602.5) për shpenzimet e kryera, që përfaqëson kostot e mirëmbajtjes së këtyre aktiveve.

**Menjëherë dhe në vazhdim**

**10. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 215 “Mjete transporti” është pakësuar në shumën 4,412,658 lekë, si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimit të një automjeti tip Volvo me targë TR8877H. Ky automjet është nxjerrë jashtë përdorimit dhe është miratuar me Vendim të KA nr. 9, datë 19.12.2018 , për asgjësim/tjetërsim dhe se qëndron në ambientet e godinës së institucionit. Drejtoria e Financës ka kryer veprimet duke e evidentuar “Mjet në ruajtje” me fletëhyrjen nr. 1, datë 27.12.2018 dhe e ka

zbritur vlerën e tij nga kontabiliteti, megjithëse nga komisioni nuk është kryer asgjësim/tjetërsimi i tij, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pika 109 ku citohet: *“Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, groposur ose djegur”.* (Më hollësisht trajtuar në pikën “C” nga faqe 65 deri në 69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**Përsa më sipër rekomandoj:** Strukturat drejtuese të ISSH, Drejtoria e Financës, të bëjë sistemimin kontabël për vlerën e mbetur në llogarinë 31 si materiale të riciklueshme për asgjësimin/tjetërsimin e automjetit tip Volvo me targë TR8877H i cili është miratuar për nxjerrje jashtë përdorimit nga KA.

**Menjëherë**

**11. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të veprimeve të kryera nëpërmjet bankës u konstatua se është kryer pagesa në shumën 647,530 lekë për z. Kreshnik Brasha me objekt: “Konsulencë në Drejtorinë e Burimeve të Informacionit të ISSH-së” sipas Kontratës së punës me kohë të pjesshme nr. 85 prot, datë 06.01.2014. Kjo Kontratë pune është nënshkruar dhe zbatuar në kundërshtim me Ligjin Nr. 136/2015 për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 13 pika 3, me rregulloren e brendshme miratuar me Vendim KA nr. 3/2, datë 26.02.2008 dhe Vendim nr. 15 KA datë 20.10.2017 “Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” Kapitulli i I-rë pika 2, komandimi i përkohshëm në detyrë, paragrafi 2.1 për arsye se në pikën 2 paragrafi parë citohet: *“Kur për nevoja operacionale, të dokumentuara kërkohet, detyrimisht, plotësimi i menjëhershëm i një vendi të lirë pune apo i një vendi pune të sapo krijuar të kontraktohen punonjës jashtë administratës së sigurimeve shoqërore”* të paragrafit 2.2 ku citohet se: *“Komandimi si më sipër zgjat vetëm për një afat kohor, maksimumi 3 muaj gjatë të cilës administrata e sigurimeve shoqërore duhet të zbatojë procedurat përkatëse dhe aktet ligjore e në nënligjore për plotësimin përfundimtar të këtij vendi pune”* si dhe të paragrafit 2.4 ku citohet se: *“Kur pavarësisht nga procedurat e mësipërme, nuk arrihet zënia e vendit të lirë të punës, komandimi shtyhet edhe për tre muaj të tjerë, dhe në këtë rast punonjësit të komanduar i jepen të gjitha kompetencat që ka posti ku është komanduar”.* Sipas organikës së miratuar së ISSH-së, nuk rezulton ky vend pune. Gjithashtu referuar totalit të shpenzimeve për mirëmbajtjen e sistemit informatikë për tre kontrata shërbimi për sistemin informatik kryhen pagesa në shumën 7,690,000 lekë/muaj për operatorin ekonomik “Infosoft System”, duke mos argumentuar nevojën e punësimit të këtij specialisti e në këto kushte kontrata rëndon shpenzimet e institucionit. (Më hollësisht trajtuar në pikën “C” nga faqe 75 deri në 83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**Përsa më sipër rekomandoj:** Strukturat Drejtuese të ISSH-së të marrin masa për ndërprerjen e Kontratës së Punës nr. 85 prot, datë 06.01.2014, me qëllim rekrutimin e specialistëve të IT sipas legjislacionit në fuqi.

**Menjëherë**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i praktikave të pagesës nëpërmjet bankës për urdhër shërbimet e punonjësve të nisur me shërbim jashtë qendrës së punës u konstatua se janë paguar gjithsej 5 ditë të plotë nga e cila është likuiduar një ditë dietë e plotë që rezulton ditë e shtunë (data 23 dhjetor 2017) për 13 punonjës që kanë shkuar me shërbim jashtë qendrës së punës, sipas programit të inspektimit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, në shumën 71,500 lekë në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 20.04.2016 për disa ndryshime në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010, *“Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar, kapitulli I “Punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, të cilët gjatë ditëve zyrtare të punës shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, trajtohen financiarisht për përballimin e shpenzimeve të shërbimit”* pika 1, ku citohet se *“Për shërbime në një largësi deri në 50 km jashtë qendrës së punës, trajtimi financiar i punonjësit përfshin vetëm shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni.”*, pika 3 ku citohet se *“Për shërbime në një largësi mbi 100km, jashtë qendrës së punës, trajtimi financiar i punonjësit përfshin: a) dietën ditore, e cila për çdo punonjës të dërguar me shërbim, llogaritet në masën, si më poshtë vijon: i) 1 000 (një mijë) lekë në ditë, kur punonjësi kthehet brenda ditës; ii) 10 % të pagës mujore, por jo më shumë se 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë/ditë, kur shërbimi zgjat më shumë se një ditë. Për efekt të llogaritjes së dietës, në këtë rast, data e nisjes dhe ajo e kthimit llogariten një ditë e plotë”.* (Më hollësisht trajtuar në pikën “C” nga faqe 75 deri në 83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**Përsa më sipër rekomandoj:** Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë masa për të forcuar sistemet e kontrollit të brendshëm në institucion në mënyrë që të eliminohen praktikat e gabuara në pagesën e shpenzimeve për dieta dhe udhëtime duke rritur vëmendjen e drejtuesve në zbatimin e rregullshmërisë financiare si dhe të arkëtohet shuma nga personat përgjegjës, sipas aneksit nr. 4, bashkalidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Menjëherë**

**13.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i praktikave dokumentare të pagesave për prokurimet me vlerë të vogël nëpërmjet bankës për periudhën janar-dhjetor 2018, rezultuan mangësi disa prej të cilave citojmë si më poshtë:

**-Për 3 subjekte/15 raste janë kryer** pagesa për prokurime mallra dhe shërbime në shumën **118,840 lekë**, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si edhe mungojnë faturat e blerësit, veprim në kundërshtim me *Udhëzimin e APP-së nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”,* ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, kreu VI, neni 54. pika 4 ku citohet: *“kuponit tatimor, i pashoqëruar me faturë, nuk njihet si dokument justifikues i shpenzimeve për blerësin, ushtrues të një veprimtarie tregtare”.*

**-Për 8 subjekte/19raste** në shumën **398,788 lekë**, nuk janë zhvilluar procedura prokurimi, blerjet janë kryer pa urdhër të titullarit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 40, pika 3 ku citohet *“Kur lind nevoja për punë, mallra ose shërbime, titullari i autoritetit kontraktor ose një zyrtar tjetër i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohen objekti i prokurimit dhe sasia e tyre”,* si dhe me pikën 6 të Udhëzimit të APP-së nr. 3, datë 08.01.2018 *“Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”,* ku citohet: *“Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohet natyra dhe sasia e mallrave, shërbimeve dhe punëve, të cilat kërkohen të prokurohen në këtë procedurë, si dhe fondi i përlllogaritur..”.*



**-Në 2 raste në shumën 6,414,000 lekë , nuk janë kryer likuidimet në afatet kohore në përputhje me Ligjin nr. 48/2014** “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, sipas nenit 7, Afati për autoritet publike , ku citohet: *“Në veprimet juridike tregtare, në të cilat debitori është autoritet publik, pas mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit nga debitori, sipas nenit 463 të Kodit Civil, dhe: Kur kreditori i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij, sipas ligjit dhe kontratës: iv) kur ligji a kontrata parashikon një procedurë të marrjes në dorëzim ose të kolaudimit, përmes së cilës vërtetohet përputhshmëria e mallrave a shërbimeve me kontratën , dhe nëse debitori e merr faturën ose kërkesë pagesën e njëvlershme përpara ose në datën kur bëhet marrja në dorëzim apo kolaudimi në fjalë, 30 ditë kalendarike pas kësaj date”*, si dhe të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *“ Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ”*, Dokumentimi i vlerave monetare pika 61 ku citohet: *“Pagesat ndërmjet njësive publike dhe entiteteve të sektorit privat bëhen nëpërmjet Sistemit të Thesarit direkt në llogarinë bankare të përfituesit. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë të detyruara të procedojnë me kryerjen e pagesës për mbylljen e detyrimeve menjëherë pas marrjes së faturës tatimore nga furnitori dhe të vërtetuar me kryerjen e shërbimit / marrjes në dorëzim të aktiveve në përputhje me kushtet e kontratës”*. (Më hollësisht trajtuar në pikën “C” nga faqe 76 deri në 78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**Përsa më sipër rekomandoj:** Instituti i Sigurimeve Shoqërore, të zbatojë procedurat e prokurimit sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 dhe *Udhëzimin e APP-së nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”*, duke forcuar vëmendjen e drejtuesve në zbatimin e rregullshmërisë financiare, pavarësisht përhapjes së vogël të këtyre praktikave.

#### **Në vazhdim**

**14. Gjetje nga auditimi:** -Komisioni i inventarizimit nuk ka vepruar sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, pika 83 “Përgjegjësitë për inventarizimin”, ku citohet se *“Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material”*.

-Me urdhrin e inventarizimit nr. 8273, datë 06.12.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm në ISSH, janë përcaktuar komisionet për kryerjen e inventarëve, detyrat e komisionit, afatet e përfundimit të inventarëve, etj, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”; Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Në vijim komisioni ka konstatuar materiale jashtë përdorimi në magazinë me një vlerë 1,230,850 lekë, amortizim të akumuluar prej 143,393 lekë dhe vlerë të mbetur 143,952 lekë. Nga auditimi u konstatua se, nuk është ngritur komisioni, për asgjësimin e aktiveve të evidentuara për jashtë përdorimit sa më sipër.

- Për automjetin tip Volvo, targë TR8877H i nxjerrë jashtë përdorimit dhe i miratuar me Vendim të KA, nr. 9 datë, 19.12.2018, për asgjësim/tjetërsim, Drejtoria e Financës ka kryer veprimet duke e evidentuar “mjet në ruajtje”, me fletëhyrje nr. 1, datë 27.12.2018 si edhe ka zbritur vlerën e tij nga kontabiliteti. Mjeti qëndron në ambientet e godinës së institucionit megjithëse dhe nga komisioni nuk është kryer asgjësimi/tjetërsimi i tij në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pika 109 *“Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si*

*vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, propozur ose djegur”. (Më hollësisht trajtuar në pikën “C” nga faqe 84 deri në 88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Përsa më sipër rekomandoj:** Strukturat drejtuese të ISSH, të ndjekin procedurat ligjore në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, për asgjësimin/tjetërsimin e mallrave të evidentuara si të papërdorshme, nga komisioni i inventarizimit.

**Menjëherë**

**15. Gjetje nga auditimi:** Në hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartuara nga Njësia e Prokurimit, kanë ndikuar në pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomik në tender si pasojë edhe në përcaktimin e Operatorit Ekonomik Fitues, duke ulur konkurrencën, si në rastin e procedurës së prokurimit, për blerje automjetesh për nevoja të ISSH. (Më hollësisht trajtuar në pikën “D” nga faqe 88 deri në 97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**Përsa më sipër rekomandoj:** Autoriteti Kontraktor, njësia e prokurimit dhe dega e administrimit, të tregojnë kujdes në përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit bazuar në nevojat reale të Autoritetit Kontraktor me qëllim arritjen që procedurat e prokurimeve të arrinë qëllimin e tyre për përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë të fondeve të vëna në dispozicion nga ana e institucionit.

**Menjëherë dhe në vazhdim.**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i programimit të buxhetit të ISSH për vitin 2018, i cili realizohet në 15 njësitë e sistemit, u konstatua se procesi i programimit buxhetor ka hasur vështirësi e problematika në vlerësimin dhe përlllogaritjen e tij, duke mos zbatuar në të gjitha fazat e programimit të buxhetit, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.10, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”, që lidhen me sa vijon:

**a. Programi i përgjithshëm i të ardhurave** si dhe ngarkesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore të subjekteve të mbledhura nga DPT, është përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Makroekonomike në Ministrinë e Financave, dhe për rrjedhojë ISSH ka marrë tregues të gatshëm për të ardhurat. Si rezultat në programimin fillestar të të ardhurave të vitit 2018, në shumën 74,656 mijë lekë, ka rezerva sepse megjithëse programimi i tyre u shtua me akte normative, përsëri të ardhurat nga kontributet, janë tejkaluara me 804 milionë lekë. Programi i të ardhurave u shtua me 3,880 milion lekë, përsëri të ardhurat e programuara u tejkaluara me 4,684 milion lekë, ose mbi 6,2% më shumë. ndërsa kundrejt planit me ndryshime realizuar më shumë për 804 milionë lekë.

**b. Gjatë programimit të shpenzimeve,** ISSH ka mbajtur në konsideratë për llogaritjen e përfitimeve për 633,000 pensionistë të të gjitha llojeve dhe kategorive, ka llogaritur e administruar kompensimet për mbi 584,000 persona të varur ekonomikisht nga pensionisti, sidomos familjarë të invalidëve, ka administruar pagesat për 5,304 veteranë dhe invalidë të luftës dhe 532 invalidë të punës, 313 pensione të posaçme, etj. Krahas tyre, ISSH vazhdon të administrojë skemën e pensioneve të posaçme, skemën e pensioneve suplementare të punonjësve që kryejnë funksione kushtetuese dhe punonjësve të tjerë të shtetit, skemën e sigurimeve suplementare të policisë dhe ushtarakëve të tjerë, skemën e përfitimeve të veçanta për minatorët, si dhe skemën e përfitimeve të veçanta për familjet e dëshmorëve me 34,500 përfitues. pilotët fluturues në pension, detarët e

nëndetëseve në pension, përfituesit e statusit “Profesor” etj,. Konkretisht për vitin 2018, janë parashikuar 28,800 përfitues të skemave suplementare dhe 28, 600 përfitues të trajtimeve të veçanta.

**c.** ISSH ka parashikuar shumën 400 milionë lekë/vit (kjo sipas relacionit të ligjit), për futjen në zbatim të statusit të naftëtarit, për 5000 naftëtarë, në zbatim të ligjit nr. 8/2017, datë 02.02.2017 “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit”, ISSH me shkresën nr. 6711/1, datë 01.08.2017, ka shpërndarë në DRSSH, udhëzimin “Mbi procedurat teknike të zbatimit të ligjit nr. 8/2017 dhe VKM nr. 425, datë 10.05.2017 “Për rregullat e organizimit, funksionimit, të komisionit për dhënien e dëshmisë së statusit të punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit, kriteret dhe procedurat për lëshimin e vërtetimit të posaçëm zyrtar”. ISSH, nuk ka filluar llogaritjen dhe caktimin e përfitimeve të parashikuara në ligjin nr. 8/2017, pa u miratuar vendimi i këshillit të Ministrave për zbatimin e dispozitave të ligjit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën “E” nga faqe 97 deri në 115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Përsa më sipër rekomandoj:** Strukturat drejtuese të MFE/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makro Ekonomike, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit në bashkëpunim me strukturat drejtuese të ISSH, të marrin masa që:

**a.** Të riorganizojnë dhe mundësojnë programimin e të ardhurave të mbledhura nga DPT dhe programimin e shpenzimeve në të gjitha fazat edhe nga strukturat e ISSH, duke shtuar bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për shkëmbimin e të dhënave për subjektet kontribuuese, të cilat mundësojnë krijimin e të ardhurave dhe për subjektet problematike, të cilat pengojnë krijimin e tyre, në mënyrë që treguesit e programimit të të ardhurave të mos vijnë të gatshme në ISSH, por të programohen referuar një analize të drejtë e pa rezerva nga të dyja strukturat.

**b.** Strukturat drejtuese të ISSH, të mundësojnë programimin e shpenzimeve nga të gjitha strukturat e varësisë dhe në të gjitha fazat e programimit, duke pasur parasysh zgjidhjen e problematikave në shpejtimin e plotësimit të bazës së të dhënave për periudhën e sigurimit të personave që kanë kontribuar në skemë.

**c.** Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të koordinojnë punën dhe në bashkëpunim me ISSH, të marrin masa për miratimin e akteve nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 8/2017, datë 02.02.2017 “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit, duke përcaktuar kategoritë përfituese të statusit, numrin e përfituesve, efektin financiar, me qëllim programimin drejt të shpenzimeve për këtë kategori përfituesish.

**Brenda vitit 2019**

**17.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i programimit të buxhetit të të ardhurave që mblidhen nga strukturat e ISSH (kontribute të vet punësuarve në bujqësi-fermerit) që për vitin 2018 janë programuar në vlerë 2,127 milion lekë, janë ndryshuar me aktin normativ nr.1, në vlerë 2,182 milion lekë, megjithëse më shumë se programimi fillestar për 55 milion lekë, u konstatua se ka vështirësi në përlllogaritjen e tyre, nisur nga fakti që koncepti fermer, lidhet me tokën që kanë në përdorim si të vetëpunësuar në bujqësi, referuar përcaktimit në ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 të ndarjes së tokës, por për shkak të ndryshimeve demografike, ky koncept për përcaktimin e “fermerit, ose të vet punësuarit në bujqësi” ka ndryshuar. Në këto kushte është e vështirë që përcaktimin e qartë të termit “fermer, ose i vetëpunësuar në bujqësi” ta zgjidhin vetëm strukturat e ISSH, në mënyrë që parashikimi i shpenzimeve për përfitime dhe kontributet e derdhura nga

fermerët, të jenë të shoqëruara me ndryshimet ligjore për këtë proces. *(Më hollësisht trajtuar në pikën “E” nga faqe 123 deri në 151 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Përsa më sipër rekomandoj:** Strukturat drejtuese të ISSH dhe njëkohësisht përgjegjëse për kontributet në ISSH (bujku), në bashkëpunim me strukturat drejtuese të MBZHR të bëjnë të mundur përcaktimin e qartë të termit “fermer” apo i “vetëpunësuar në bujqësi”, shoqëruar këtë ri-përcaktim me ndryshimet ligjore përkatëse, me qëllim rritjen dhe saktësimin e programimit të të ardhurave nga kontributet në sektorin e bujqësisë.

## Brenda vitit 2019

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga analiza dhe auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të Aparatit rezultoi se:

-Planifikimi fillestar i shpenzimeve për investime për vitin 2018, ishte zero, realizuar 15,254 mijë lekë.

- Planifikimi fillestar i shpenzimeve për kompensime dhe detyrime legale për vitin 2018, ishte zero, realizuar 743 mijë lekë.

-Realizimi i buxhetit administrativ të Aparatit gjatë vitit 2018, është 31% më shumë se një vit më parë, e kjo kryesisht në shpenzimet operative;

-Nga analiza e shpenzimeve operative (artikulli 602) dhe ndryshimi që pësojnë ato nga viti në vit, rezultoi se planifikimi i tyre megjithëse ishte bërë i detajuar, kishte ndryshime të mëdha në zëra të ndryshëm gjatë krahasimit të tyre me realizimin e vitit të kaluar dhe ndryshime të theksuara gjatë fazave të programimit të tyre.

-Ndryshimet (shtesat) në programin fillestar nuk kanë qenë të nevojshme dhe të argumentuara, pasi rezulton se për zërat e shpenzimeve realizimi është më i ulët edhe nga plani fillestar.

-Me rritjen e fondit të pagave, duhet të ishte reflektuar rritja edhe për zërin “*Kontribute për sigurime shoqërore e shëndetësore*” me 16.7 % nga vlera e programuar në planin fillestar.

-Po kështu, e pa argumentuar është rritja për zërin “*Mallra dhe shërbime të tjera*”, i cili ka një mosrealizim nga plani i ndryshuar me 20,575 mijë lekë, si edhe 6,573 mijë lekë nga plani fillestar, për zërin “*shpenzime për organizatat ndërkombëtare*” i cili ka një mosrealizim nga plani i ndryshuar me 713 mijë lekë, si edhe 373 mijë lekë, nga plani fillestar.

Duke krahasuar realizimin e vitit 2018 me vitin 2017, rezulton se për 2018 megjithëse janë ulur shpenzimet për mallra dhe shërbime, janë rritur në mënyrë të ndjeshme shpenzimet për investime.

-Megjithëse shpenzimet janë mbajtur nën kontroll, realizimi i tyre për 14.2% më pak, nuk është real, pasi kjo diferencë është e njëjtë me shtesat e pa argumentuara gjatë vitit që janë bërë në planin fillestar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën “E” nga faqe 115 deri në 122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Përsa më sipër rekomandoj:** Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, të marrë masa që gjatë fazës së programimit dhe ndryshimeve gjatë vitit, të programohen në mënyrë të detajuar shpenzimet administrative të Aparatit të ISSH, si për kostot operative, ashtu edhe për ato të investimeve, në mënyrë që ndryshimet në zërat analitikë të tyre, të justifikojnë, argumentojnë dhe dokumentojnë domosdoshmërinë e ndryshimit nga viti në vit dhe gjatë vitit buxhetor.

## Brenda vitit 2019

**19. Gjetje nga auditimi:** Të ardhurat nga kontributet dhe të ardhura të tjera, të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), zënë për këtë vit 62% e të ardhurave nga kontributet gjithsej të hyra në ISSH, në vlerë **79,340.23 milion lekë**, për të cilat evidentohen problematika të tilla si:

**a.** Në subjektet e biznesit të madh, subjektet fason, në disa subjekte që zhvillojnë veprimtari profesionale, në media etj, ka rezerva për rritjen e të ardhurave nga kontributet.

**b.** Konstatohet se ka mungesa në numrin e listë pagesave vjetore që duhet të dërgojë DPT-ja në ISSH dhe veçanërisht këto të identifikuar për vitin 2006-2012 , ku mungojnë një sasi e konsiderueshme listë pagesash formatit letër në shumën 1,520,423. Gjithashtu janë konstatuar mungesa të konsiderueshme listë pagesa elektronike (pas Janarit të vitit 2012) në shumën prej 1,841,174. Megjithëse është vënë në dijeni zyrtarisht DPT-ja dhe po merren masat që ky informacion të kalojë në ISSH, pasi ato listë pagesa gjenden në bazën e të dhënave të DPT-së, akoma kjo problematikë është në proces zgjidhje teknike, duke krijuar problematika në përdorimin on line të kësaj baze, për caktimin e pensioneve të personave që kanë mungesa.

**c.** Nga auditimi i të dhënave që përpunon sistemi CMIS ( Sistemi elektronik i Menaxhimit të Kontributeve) në ISSH , rezultoi se nuk jepen të dhëna sipas llojit të subjekteve (buxhetorë, jo buxhetorë , të vetëpunësuar etj) në lidhje me derdhjen e të ardhurave dhe evidentimin e listë pagesave të munguara pasi të dhënat që përpunon sistemi janë sipas informacionit që transmetohet nga DPT i cili rezulton i transmetuar pa kodin e identifikimit për çdo subjekt(buxhetor, vetëpunësuar, etj..) i cili duhej të realizohej bazuar në specifikimet teknike, të vendosura në marrëveshjen ndërmjet DPT dhe ISSH të datës 15.09.2014. DPT duhet të transmetoj drejt ISSH të dhëna sipas të dhënave referenciale të ndërveprimit (Format Ligjore) të përcaktuara veprim i cili bën të mundur identifikimi nga ISSH të formës ligjore të subjektit gjatë përpunimit të informacionit në ISSH.

**d.** Janë konstatuar në fund të vitit 2018 mos rakordimi në kohë nga Degët e Arkivit të DRSSH të të dhënave të subjekteve pages të kontributeve të sigurimeve shoqërore me listë pagesat e dorëzuara ( formati letër) nga DPT me qëllim hartimin e listës përfundimtare të subjekteve pages së bashku me mungesat e konstatuara të listë pagesave me qëllim ndjekjen e tyre nga DRSSH bazuar në shkresën nr. 2835, datë 13.04.2018 “Për grumbullimin e listë pagesave të munguara të formatit letër të subjekteve aktive dhe jo buxhetore për periudhën tatimore Janar 1994-Dhjetor 2012”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën “E” nga faqe 123 deri në 151 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

### **Përsa më sipër rekomandoj:**

**a.** Strukturat drejtuese të ISSH, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të MFE/Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve, të riorganizojnë dhe mundësojnë evidentimin e subjekteve të biznesit të madh, subjektet fason, dhe subjektet që zhvillojnë veprimtari profesionale, në media etj, të cilat nuk paguajnë në rregull, apo nuk derdhen fare kontribute të sigurimeve shoqërore për të punësuarit e tyre.

**b.** Të ndiqen me prioritet nga Strukturat drejtuese të ISSH, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të MFE/Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve mungesa e listë pagesave nga subjektet kontributive me qëllim, për të eliminuar mungesën së periudhave të sigurimit, nëpërmjet analizës së debitorëve për periudhat e mëparshme dhe duke u bërë rast pas rasti rregullimin dhe plotësimin e tyre. E Konkretisht:

- Strukturat drejtuese të ISSH, të ngrëjë sipas një programi grupin e punë i cili të këtë mundësinë në bashkëpunim me strukturat drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve e hartimit të

listë pagesat e munguara të formatit letër të periudhës 2006-2012, në shumën 1,520,423 rreth 94,4% e tyre janë listë/pagesa të munguara të vetë punësuarve (biznes i vogël), dhe 80,910 ose 5,32% janë listë pagesa të munguara të biznesit të madh dhe 4,534 ose 0.3% janë listë pagesa të subjekteve publike, buxhetorë dhe jo buxhetorë dhe të ndiqen dhe mungesat e konstatuara në listë pagesa elektronike ( pas Janarit të vitit 2012) në shumën prej 1,841,174, me qëllim zgjidhjen e mungesave të krijuara dhe sigurimin se proces të monitorohet në vazhdimësi .

**c.** Institucioni në bashkëpunim me DPT të realizojë mundësinë e dërgimit të dhënave që transmetohen nga DPT) në ISSH si për të ardhurat (kontributet) dhe të listë pagesave të kontributeve sipas llojit të subjekteve (buxhetorë, jo buxhetorë , të vetëpunësuar etj) me qëllim që të realizojë përpunimit të të dhënave nëpërmjet sistemit CMIS (Sistemi elektronik i Menaxhimit të Kontributeve) në lidhje me derdhjen e kontributeve sipas kodit të identifikimit për çdo subjekt (buxhetor, vetëpunësuar, etj..) bazuar në specifikimet teknike, të vendosura në marrëveshjen që DPT duhet të transmetoj drejt ISSH sipas të dhënave referenciale të ndërveprimit (Format Ligjore) veprim i cili do të bëjë të mundur identifikimi nga ISSH sipas të formës ligjore të subjektit të derdhjes së kontributeve dhe evidentimin e detyrimeve kontributeve dhe listë pagesave të munguara.

**d.** Nga ana e Degëve të Arkivave në DRSSH të përfundojë hartimi i Listës Përfundimtare të subjekteve pagues të kontributeve sipas periudhave përkatëse të listë pagesave ( formati letër), të rezultuara mangët me qëllim ndjekjen e mungesave të krijuara nga Janari i vitit 1994 deri më Dhjetor 2012

**Brenda vitit 2019**

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga Drejtoria e Kontributeve të këtij institucioni është raportuar se numri i subjekte debitorë në 2018 është 72,740, **në vlerë 11,932,717 lekë**, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 10,848,442 lekë. Debitorët e sigurimeve shoqërore që evidentohen në DPT, prodhon një problem mjaft të madh social dhe financiar për organet e sigurimeve shoqërore, sepse pas subjekteve debitorë dhe shumave të papaguara të kontributeve, janë një numër i konsiderueshëm personash të punësuar në këto subjekte, të cilët nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore, por ka efekt financiar, sepse deri tani, fondit të sigurimeve shoqërore, nuk i janë vënë në dispozicion rreth 12 miliard lekë detyrime kontributive të prapambetura. Për këtë vit, po dhe në vazhdimësi ISSH ka bërë prezent organeve eprore problemin shqetësues të numrit të lartë dhe detyrimeve të prapambetura, për kontribute të papaguara, të subjekteve debitorë, në organet tatimore. Këta janë debitorë të krijuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për kontributet e sigurimeve shoqërore të deklaruar dhe të pa derdhura në ISSH, ose kontribute të deklaruar më shumë se sa janë derdhur për llogari të ISSH e të pa shoqëruara me listë pagesat përkatëse. Në kontabilitetin e këtij institucioni nuk janë të regjistruar, por janë vetëm si evidencë statistikore në Drejtorinë e Kontributeve të këtij institucioni.

Gjithashtu problematikë shqetësuese nga auditimi rezulton dhe debitorët e evidentuar të vetë punësuarve në bujqësi të cilat rezultojnë në fund të vitit 2018 në vlerë 1,439,181,189 lekë dhe i përkasin 17,577 persona , ndërsa në fund të vitit 2017 ka qenë 30,451 persona në vlerë prej 472,903.09 lekë, duke pësuar një rritje të detyrimeve në shumën prej 1,438,708 mijë lekë. Rritja ka ardhur kryesisht nga mospagimi i detyrimeve të vetë punësuarve në bujqësi në 12 DRSSH. *(Më hollësisht trajtuar në pikën "E" nga faqe 123 deri në 151 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Përsa më sipër rekomandoj:** Nga ana e institucionit të ndërmerren iniciativa për publikimin e listave të subjekteve debitorë në DPT dhe ndërhyrje nga ana e MFE me qëllim zgjidhjen e

problematikës së krijuar ndër vite dhe minimizimin e evazionit fiskal të krijuar në derdhjen e kontributeve. Gjithashtu nga ana e ISSH të ngrihen grupe pune pranë DRSSH në monitorimin e Drejtorisë së Kontributeve , në lidhje me evidentimin , ndjekjen e detyrimeve debitorëve të vetë punësuarve në bujqësi të cilat rezultojnë në fund të vitit 2018 në vlerë 1,439,181,189 lekë me qëllim arkëtimin e këtyre detyrimeve.

#### **Deri në fund të vitit 2019**

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) u konstatua se për vitin 2018 ka realizuar 12 misione auditimi nga 12 misione të planifikuara, nga të cilat 9 auditime financiare, 1 përputhshmërie, dhe 2 tematike. Në përfundim rezultoi sa më poshtë vijon:

- DAB, gjatë periudhës kur drejtohej nga z. Lula nuk ka hartuar, projekt raportin e auditimit pas përfundimit të auditimit në terren, duke hartuar direkt raportin e auditimi, në kundërshtim me kërkesat që dikton Standardi 2410 “Kriteret për komunikim” si dhe me kapitullin 4/ pika 4.6 e Manualit të Auditimit të Brendshëm;

- Gjatë auditimit nuk na u vendos në dispozicion korrespondenca e drejtuesit të DAB me Bordin dhe Drejtorin e Përgjithshëm, sa i takon raportimit periodik të DAB-së te menaxhimi i lartë dhe bordi, mbi qëllimin dhe njohjen me rezultatet e aktivitetit të Auditit të Brendshëm (AB), në raport me planin e tij, sikundër specifikohet në pikën 3.1 “Plani strategjik i auditimit”, te Manuali i AB-së, si dhe në Standardin 2060.

-nuk kryhet auditim i veçantë për vlerësimin e rekomandimeve të lëna. *(Më hollësisht trajtuar në pikën “F” nga faqe 176 deri në 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Përsa më sipër rekomandoj:** Drejtuesi i DAB-së të marr masa që në raportimet periodike tek menaxhimi i lartë dhe bordi, ndër të tjera të përfshijë ekspozime ndaj rrezikut material dhe çështje të kontrollit, duke përfshirë rreziqet e mashtrimit, çështjet e qeverisjes së organizatës dhe çështje të tjera të nevojshme ose të kërkuara nga menaxhimi i lartë dhe bordi. Nisur nga fakti se Bordi është i pranishëm në këtë institucion, të merren masa për të praktikuar korrespondencën e raportimit me Bordin dhe Drejtorin e Përgjithshëm zyrtarisht, duke lënë gjurmë edhe për to.

#### **Brenda vitit 2019**

**22. Gjetje nga auditimi:** Në bazë të programit të kontrollit të Njësisë së Inspektimit të Përfitimeve me nr. 543 prot , datë 23.01.2018 janë kontrolluar për vitin 2018 gjithsej 47,810 dosje përfitimesh të lidhura nga vitet 2014 nga të cilat rezultuan:

Dosje pensioni të pa certifikuara gjithsej **1, 004** (Përfitime afatgjata për vitet 2014-2015-2016) nga 36,761 dosje të kontrolluara dhe 495 dosje me detyrime debitore në shumën prej 36,385,629 lekë dhe 834 dosje me detyrime kreditore në shumën prej 44,155,783 lekë, dosje të lidhura në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, i ndryshuar dhe **274 dosje të pa certifikuara** ( Përfitime suplementare) për vitet 2015-2018 në zbatim të ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996 “ Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe punonjësve të shtetit”, i ndryshuar. Gjithashtu rezultojnë dhe **5,985 dosje** përfitimesh( suplementare e trajtimeve të veçanta) të caktuara nga viti 2017 e në vazhdim, të cilat janë të pakontrolluara (sipas listës nr. 1,2,3)të projekt raportit). Referuar nenit 62 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar ”, ky afat është 3 vjeçar dhe është përcaktuar si afat parashkrimi për pensionet e njohura dhe të paguara dhe brenda

këtij afati duhet kryer kontrolli, verifikimi dhe certifikimi i pensioneve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën "G" nga faqe 184 deri në 194 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**Përsa më sipër rekomandoj:** Me qëllim administrimin me efektivitet të fondeve të pensioneve. Institucioni të marrë masa që planifikimi i kontroleve në vijim nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve të kryhen brenda vitit të lidhjes së pensioneve dhe të përfundojë inspektimin për 1,278 të pa çertifikuara dhe kontrollin për 98,353 dosje të pa kontrolluara nga vitet 2016 e në vazhdim.

## **Përgjatë vitit 2019 e në Vazhdim**

### **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur ne ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës" i ndryshuar, nenet 37, 141, 153 pikat 1 dhe 2, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, analizimin e shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe ngritjen e Komisionit të Disiplinës për fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara ndaj nëpunësve përgjegjës.

### **D. SHËNIM I KRYETARIT.**

1. Mbështetur në sugjerimin e Kryeaudituesit të Departamentit për auditimet e zhvilluara në ISSH, gjetjet dhe rekomandimet që KLSH ka dhënë në këto katër vitet e fundit, auditimi që do të zhvillohet në janar të vitit 2020 do të përfshijë si analizë integrale edhe tre apo katër vitet e mëparshme, përmes një programi auditimi në sistem i cili do të shfrytëzojë gjetjet dhe trajtimet në auditimet e mëparshme përfshirë edhe auditimin e zhvilluar nga Departamenti i Auditimit të Performancës në gjashtë mujorin e parë të këtij viti ( i cili evadohet në shtator të vitit 2019) si dhe problematika që nuk janë trajtuar më parë. Ky auditim i radhës do të drejtohet nga Drejtori i Departamentit të Buxhetit.

2. Opinioni i auditimit i përcaktuar nga grupi i auditimit do të diskutohet përgjatë muajit shtator nga grupi i auditimit, Kryeaudituesi i Departamentit, Drejtorja e Sigurimit të Cilësisë dhe Drejtori i Përgjithshëm me qëllim për të arritur në një unifikim mendimi.

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.*

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**